

***“Deri sa mos ta ndryshojnë (pozitivisht)
gjendjen e tyre”***

PENDIMI

Profesor:
Amr Halid

Për botuesin ERIXH LIN-NESHRI

Autor:

Prof. AMR HALID

Titulli i origjinalit:

التوبة

Titulli:

PENDIMI

Përktheu:

Dr. Musli VËRBANI

Korrektor:

Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*

Mumin Shehu

Kaçanik

2006

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

Hyrje

Vërtet çdo falënderim i takon vetëm Allahut, prandaj ne vetëm Atë e falënderojmë, vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë, nuk kërkojmë udhëzim tjetër pos çka na udhëzon Ai, Atij i kërkojmë falje, i mbështetemi Allahut nga të metat tona dhe nga të këqijat e veprave tona. Cilin e udhëzon Allahu, ai nuk humb kurrë, mirëpo cilin e humb Allahu, për të nuk ka udhëzues.

Përshtëndesim dhe dërgojmë salavate për më të mirin e krijesave, më të zgjedhurin dhe më të ndriturin - robin e Allahut dhe të dërguarin e Tij - Muhamedin a.s.. Përshtëndesim edhe familjen e tij të mirë dhe të pastër, shokët e tij të mirë dhe të pastër në përgjithësi, dhe ata të cilët i pasojnë gjurmët e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Ajo çka po ndodhë për çdo ditë tek muslimanët si: nënçmimi i ndërsjellët, urrejtja në mes vete, problemet, ndarja, përçarja, copëtimi, konfrontimi, hidhërimi etj., të gjitha këto na obligojnë neve që patjetër t'i lëmë dhe të largohemi prej kundërshtimeve mes vete, konfrontimeve, hidhërimeve, nënçmimeve.

Të gjitha këto na obligojnë të mbjellim parimin e vëllazërimit dhe çlirimit e zemrave në gjokset tonë, para se të bëhet vonë dhe para se të na shkojë jeta pa bërë punë të mira. Të gjitha këto na obligojnë domosdoshmërinë e kthimit sa më shpejt tek Allahu Gjithëfalës dhe i Gjithëfuqishëm; t'i lëmë anash konfrontimet, kundërshtimet, hidhërimet, nënçmimet dhe t'i lutemi Allahut që t'i lartësojë dhe t'i ngritë muslimanët edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, njëherit t'i mbrojë muslimanët nga nënçmimi, poshtërimi, ndarja, përçarja dhe shpërndarja.

Le të jetojnë në këtë dunja (botë) me nderë, fuqi, zhvillim dhe qeverisje, ndërsa në botën tjetër me vendbanimet me të larta të Xhenetit dhe shpëtim prej zjarrit të Xhehenemit. Kjo do të jetë vërejtje dhe dëshmi se vërtetë - **“Allahu kurrë nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre.”**

(Err Rra`d, 11)

Deri sa të arrijmë me këtë parim (maksimë) në çështjet më të rëndësishme dhe më madhore, përpos një pjese që i ka mbrojtur Allahu dhe i ka mëshiruar nga të tjerët, të tjerët janë në shkatërrim të zemrave të tyre dhe të muslimanëve, duke shkaktuar kundërshtime, konfrontime, ndarje dhe përçarje. Duhet të angazhohemi që ta heqim këtë ves të keq dhe virusin shkatërrimtar për të kaluar jetë të lumtur, të qetë dhe të mirë edhe në këtë botë, edhe në botën

tjetër. Për t'u angazhuar në përmirësimin dhe ndryshimin e gjendjes faktike të mjerueshme, e për të arritur në një gjendje të ndershme, të lartë, të ndërtuar mbi bazat e vëllazërimit, unitetit, fuqisë, krenarisë, deri tek triumfi dhe qeverisja Islame dhe e muslimanëve.

“Vërtetë Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre”.

(Err-Rra'd, 11)

* * *

Vëlla!

Kemi folur shumë për pendimin, mirëpo ajo çka u ndodh për çdo ditë muslimanëve: vrasja, dëbimi, kërcënimi na bën me dije që ta kujtojmë Allahun dhe të pendohemi për së tepërmi. Na bën me dije domosdoshmërinë e kthimit te Allahu, nënshtrimit ndaj Tij, që ta forcojë dhe ta ngritë islamin dhe muslimanët. Për çdo ditë lëndime dhe vrasje të panumërta. Për çdo ditë i ndodhë diçka islamit dhe muslimanëve, dëshirojnë ta shkatërrojnë islamin dhe t'i dëbojnë muslimanët. E gjithë kjo, ndërsa ne flemë thua se nuk ka ndodhur asgjë! Për këtë arsye është e domosdoshme të përkujtohet pendimi dhe kthimi tek Allahu i Lartmadhëruar.

Kjo është rruga më e mirë për t'ia kthyer islamit dhe muslimanëve fuqinë, krenarinë dhe vendin e merituar.

Lus Allahun dhe shpresoj se kjo ligjëratë dhe ky mesazh do t'i bëjë dobi të shumëfishtë çdo lexuesi, mesazh i cili bën që vazhdimisht të pendohemi te Allahu i Lartmadhëruar, me pendim të sinqertë dhe të gjithë së bashku. Të jetë rrugë që të kthehemi te Zoti i Lartmadhëruar, t'i përmbahemi fesë së Zotit tonë dhe sunetit të Pejgamberit tonë. Të jetë rrugë për t'ia kthyer reputacionin, forcën dhe vendin e merituar umetit tonë.

Vërtet ndihmës dhe përkrahës e kemi vetëm Allahun dhe Ai ka mundësi për çdo send.

PSE PENDIMI?!

Dëshirojmë të pendohemi!

Posa kanë filluar sulmet amerikane kundër Irakut, një djalosh më ka dërguar një letër ku shkruante:

“Frikësohem se ajo çka po ndodhë në Irak është shkak i mëkateve të mia”.

Dëshirojmë të pendohemi!

A nuk ka mundësi që Allahu i Lartmadhëruar ta shohë Umetin, i cili i lutet me përulje dhe i nënshtruar: “O Zoti ynë kërkojmë falje te Ti për gabimet dhe mëkatet tona”.

A nuk mund të na vijë neve nata e ne duke iu lutur Allahut të Lartmadhëruar e të nesërmen në mëngjes ta shohim rezultatin e pendimit të asaj nate?!

Dëshirojmë të pendohemi!

Ndoshta Allahu duke ia pranuar tevben njërit prej nesh, na përmirëson gjendjen (pozitën) e të gjithë neve. Për Allahun kjo është shumë e lehtë. Pozita e muslimanëve të sotit nuk është asgjë tjetër, pos sprovë:

“Këtë (masë ndëshkuese) e bëri ngase Allahu nuk ishte ndryshues i një begatie, të cilën ia ka dhuruar një populli, derisa të ndryshojë ai vetë në vetvete (të bëhet përbuzës i së mirës) dhe ngase All-llahu dëgjon (çka thonë) dhe di (çka punojnë)”.

(El-Enfalë, 53)

Vëlla!

A ke vullnet të fuqishëm dhe vendosmëri të sigurtë për tu penduar te Allahu i Lartmadhëruar?

Nëse ju keni vullnet për pendim, Allahu i Lartmadhëruar do t’ua pranojë pendimin pa marrë parasysh se çfarë mëkate keni bërë.

Eja të pendohemi të gjithë së bashku. Eja të pendohemi të gjithë së bashku te Allahu i Lartmadhëruar.

Të pendohemi për mëkatet e mëdha e të vogla. Të pendohemi për mëkatet tona që me vite nuk i kemi ndryshuar pozitivisht, nuk kemi dhënë këshilla, nuk kemi urdhëruar në punë të mira, nuk kemi parandaluar krimin, por vetëm kemi thënë se kjo nuk është çështje e jonë.

Të pendohemi për pakujdesinë dhe neglizhencën tonë, që nuk kemi bërë thirrje në rrugë të Allahut të Lartmadhëruar. Nëse posaçërisht ne hatibat e xhamive, ligjëruesit, thirrësit e lusim Allahun me singëritet dhe me përkushtim, nuk do të ishim kurrë në këtë pozitë që jemi. Nuk do të derdhej gjaku i vëllezërve tanë në Palestinë, Çeçeni, Afganistan, Irak dhe në vendet tjera. Kjo është shkak i përtacisë, pakujdesisë dhe neglizhencës në thirrje në rrugë të Allahut të Lartmadhëruar; shkak i pasivitetit dhe mos aktivitetit në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar, dhe shkak i mosthirrjes së njerëzve në rrugën e drejtë dhe të qëndrueshme.

Të pendohemi për pasivitetin dhe mosaktivitetin tonë!

Tragjike dhe pikëlluese është se këtë e konsiderojnë çështje të vogël, ndërsa te Allahu është mëkat i madh:

“Kur ju atë (shpifjen) e përcollët me gjuhën tuaj dhe për atë që nuk kishit kurrfarë dije flisnit duke menduar se ajo ishte imtësi e parëndësishme, ndërsa te All-llahu ajo është e madhe”.

(En-Nur, 15)

Vëlla!

Po si insiston në mëkate dhe nuk largohesh prej tyre, ndërsa vëllezërit e tu në Palestinë, Irak dhe vende të tjera islame vriten, dëbohen dhe maltretohen?!

Eja të gjithë së bashku të pendohemi te Allahu i Lartmadhëruar!

Ejani të pendohemi se pendimi juaj, lutja juaj, përkushtimi juaj ndihmon në fitoren dhe ndihmën e vëllezërve tuaj musliman. Kjo është arsye e fortë për t'i shpëtuar ata, për t'i ruajtur ata dhe për t'iu ndihmuar atyre deri në fitore.

Nuëman bin Beshiri transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

“I sheh se si besimtarët në ndërmëshirësi, dashuri mes vete dhe simpati e respekt mes vete janë si një trup i vetëm, kështu që kur të dhemb një organ apo një pjesë e trupit, rënkon i tërë trupi dhe ndien dhembje”.

(Sahih Buhari)

Po ashtu nga ai transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Besimtarët janë si një trup i vetëm, kështu që kur dhemb e ankohet koka, i tërë trupi dhe të gjitha organet lëngojnë dhe ndiejnë dhembje”.

(Sahih Muslim)

Eja të gjithë së bashku të pendohemi te Allahu i Lartmadhëruar!

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Thuaj: O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së All-llahut, sepse All-llahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është Mëshirues!”

(Ez-Zumer, 53)

Kurrë mos ta humbim shpresën në mëshirën e Allahut të Lartmadhëruar, i Cili veten e Tij e ka quajtur: FALËS, PRANUES I PENDIMIT dhe MËSHIRUES, për shkak tëndin, për t'i falur lëshimet dhe lajthitjet tua, për të të dhënë forcë, për t'i mundur epshet dhe të dyshimtat.

Kurrë mos e humb shpresën te Allahu i Lartmadhëruar. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Vërtet, Allahu i do penduesit dhe i do të pastrit”.

(El-Bekare, 222)

Nëse pendohesh te Allahu, Ai të do, sepse Zoti i do të penduarit.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“A nuk e dinë se vërtet Allahu është Ai i cili pranon pendimin prej robërve të Tij”.

(Et-Tevbe, 104)

Zoti i Lartmadhëruar gjithashtu thotë:

“All-llahu dëshiron t’ju pranojë pendimin, e ata që ndjekin dëshirat e epsheve, dëshirojnë që ju të shmangeni në tërësi (nga rruga e drejtë).

All-llahu dëshiron t’ju lehtësojë (dispozitat), e megjithatë njeriu është i paaftë (për t’ju përballuar epsheve)”.

(En-Nisa, 27, 28)

Vërtet Allahu gëzohet për pendimin e robit të Tij, sepse Zoti i Lartmadhëruar është Falës i mëkateve dhe Pranues i pendimeve:

“I cili falë mëkatin dhe pranon pendimin dhe që është ndëshkues i ashpër, por edhe bamirës. Nuk ka zot tjetër përveç Atij. Te Ai është e ardhmja e çdokujt”.

(Gafir, 3)

Ejani, që të gjithë së bashku të pendohemi!

A ke harruar se ti je krijesë e dobët, dhe asgjë nuk mund të të forcojë, pos pendimit dhe kthimit te Allahu i Lartmadhëruar, deri sa kjo dobësi mos të zëvendësohet me forcë dhe fuqi?!

A mos ende është mëkati më i shtrenjtë se pendimi te Allahu i Lartmadhëruar dhe mbështetja te Allahu i Lartmadhëruar?!

A nuk po turpërohesh që të mbetesh i fundosur në mëkate dhe në epshe, ndërsa vëllezërit tjerë vuajnë dhe rënkojnë nga armiqtë e islamit?!

A nuk je duke e ditur se fundosja jote në epshe dhe largimi nga dëgjimi i Allahut janë pikësnyime kryesore të Iblisit, i përkrahësve të tij masonit dhe armiqve të tjerë të islamit?!

A nuk je duke e ditur se fundosja e jote në epshe i ndihmon armiqve të islamit për ta fundosur islamin dhe për t'i shkatërruar vëllezërit e tu në Palestinë, Irak dhe në vende të tjera islame?!

A nuk je duke e ditur se refuzimi dhe mospendimi yt janë padrejtësi ndaj vetës suaj?!

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

“Dhe kush (ata të cilët) nuk pendohet, ata janë të padrejtë”.

(El-Huxhuratë, 11)

Vëlla!

Vërtet Allahu i ka ndarë njerëzit në dy lloje! Pra, njeriu mund të jetë: ose pendues, ose kriminel dhe pos këtyre dy grupeve nuk ka tjetër.

Refuzuesi i pendimit në Allahun është kriminel i vetës së tij, sepse ai nuk dëshiron të pendohet;

sepse nuk dëshiron ta shpëtojë veten e tij nga zjarri i xhehenemit; sepse ai mendon se nuk ka mëkate;

sepse ai mendon se nuk ka nevojë për Allahun, ose mendon se është i pavarur nga Allahu;

sepse ai ndoshta ka harruar se do ta takojë Allahun dhe para Tij do të jep llogari për punët e vogla e të mëdha;

apo ndoshta i ka humbur shpresat dhe ka harruar se Allahu i falë gabimet e të gjithëve, nëse ata së bashku pendohen;

apo ndoshta ai nuk e di se mëshira e Allahut është aq e gjerë sa që përfshinë çdo send.

Ejani që së bashku të pendohemi te Allahu i Lartmadhëruar!

Pse mos të pendohemi për mëkatet ndaj Allahut?!

Pse mos të pendohemi për mëkatet ndaj vëllezërve tu?!

Pse mos të pendohemi për mëkatet tua?!

Pse mos të pendohemi se nuk kemi qenë mirënjohës ndaj Allahut për të mirat që na ka dhënë?!

Pse mos të pendohemi për moskryerjen e obligimeve ndaj Allahut të Lartmadhëruar?!

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Pendohuni te Allahu të gjithë së bashku o ju besimtarë”!

(En-Nur, 31)

Ejani që të gjithë së bashku të pendohemi te Allahu i Lartmadhëruar!

A nuk e kemi shembullin më të mirë te i Dërguari i Allahut s.a.v.s.?!

Edhe pse ka qenë i mbrojtur prej gabimeve, ai vazhdimisht kishte dëshirë të kërkonte falje dhe të pendohet. A nuk na tregon kjo, se edhe ne të kërkojmë falje dhe të pendohemi sa më shumë.

Si është e mundur që, i mbrojturi prej gabimeve të pendohet prej gabimeve të Zotit i Lartmadhëruar, kërkon falje prej Tij, ndërsa mëkatari nuk pendohet dhe nuk kërkon falje prej Tij?!

Përse nuk pendohesh?

Ebu Hurejre r.a. transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin s.a.v.s. duke thënë:

“Për Zotin! Unë pendohem dhe kërkoj falje prej Zotit më shumë se shtatëdhjetë herë në ditë”.

Egarrel Muzeniji transmeton se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Vërtet zemra ka nevojë dhe pikërisht për këtë unë pendohem dhe kërkoj falje prej Allahut njëqind herë në ditë”.

(Sahihul Muslim)

Ibni Umeri r.a. ka thënë se: Në një vendtubim, deri sa nuk është ngritur prej aty, i janë numëruar Muhamedit a.s. njëqind herë fjalët: *“O Zot, m’i fal gabimet, më kthe tek Ti, vërtet Ti je Falës dhe Pranues i pendimeve”.*

(Suneni Tirmidhiut)

Vëlla!!

Si është e mundur që Pejgamberi s.a.v.s. i mbrojtur prej gabimeve, kërkon falje dhe pendohet, ndërsa ti nuk kërkon falje dhe nuk dëshiron të pendohesh?!

Si është e mundur që ti nuk dëshiron t’i zhdukësh dhe t’i çrrënjosësh mëkatet, ndërsa Mesxhidi Aksaja është nën thundrat e uzurpatorëve?!

Si është e mundur që ti nuk dëshiron t'i zhdukësh dhe t'i çrrënjosësh mëkatet, ndërsa Iraku okupohet dhe burgosen banorët e tij?!

Ejani që të gjithë së bashku të pendohemi te Allahu i Lartmadhëruar!

Shpresoj se umeti i Muhamedit a.s. pendohet te Zoti i Lartmadhëruar.

Shpresoj se pozita e muslimanëve prej gabimeve dhe mëkateve të zëvendësohet me pendim, kthim te Zoti dhe devotshmëri.

Si do të ishte pozita e muslimanëve sikur të pendoheshin dhe të ktheheshin te Allahu?

Kjo është pyetje që nuk do përgjigje, sepse përgjigja është e ditur dhe e qartë, bile më e qartë se vet pyetja!

Vërtet Allahu gëzohet dhe kënaqet kur pendohet robi i Tij. E kur të jetë i kënaqur Sundimtari i të gjithë sunduesve prej robërve të Tij, pasojnë të mirat dhe begatitë e shumta të Tij.

Enes bin Maliku transmeton se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Allahu aq shumë gëzohet kur pendohet robi i Tij, sikurse ndonjëri prej jush të jetë me kafshën e tij në një shkretëtirë, dhe kafsha e tij e ngarkuar me ushqim dhe ujë i humbë, ndërsa ai i humb të gjitha shpresat për ta gjetur. Shkon nën një hije dhe shtrihet i preokupuar se kurrë më nuk do ta gjejë. Deri sa ai qëndron nën hije, kur befasisht, kafsha e ngarkuar me ushqim dhe pije i qëndron pranë. Ai e kapë për litari

dhe me gëzim të madh thotë: - O Zot, Ti je rob i im, unë jam Zoti yt. Pra, prej gëzimit të madh i ka gabuar vetat. Më vonë është penduar”.

(Sahih Muslim)

Vëlla!!

Pse të mos pendohesh, kurse Allahu gëzohet për shkak të pendimit tënd dhe kthimit tek Ai më shumë se sa është gëzuar ai i cili e ka humbur kafshën e tij në të cilën ka pasur ushqim dhe ujë, pasi që i ka humbur shpresat se do ta gjejë, pasi që i ka humbur shpresat për jetë, dhe është shtrirë nën hijen e lisit duke e pritur vdekjen.

Vëlla!!

Kush gëzohet më shumë për pendimin: i fuqishmi, i pavaruri, fisniku e mbizotëruesi; apo i varfëri dhe i ulëti?

A mund ta dish, cili prej tyre është më i gëzuar se tjetri?

Ai është i pasuri, fisniku i cili jep e nuk refuzon: nuk e refuzon lypësin, nuk refuzon atë i cili dëshiron t'i afrohet Atij, nuk e refuzon atë i cili kthehet tek Ai. E vërtet Ai meriton të adhurohet, të lavdërohet dhe falënderohet; meriton përkushtim, mirënjohje, e jo mosbesim.

Vërtet, Ai është Allahu, nuk ka zot pos Tij, Ai është Sundimtari, i Fuqishmi, i Pasuri, Fisniku, i Urti, Pranues i pendimeve, Falësi, i Urti i Mëshirshmi.

Për Zotin më e dashur është dhënia e begative, se sa pengimi i tyre; më e dashur është kënaqësia për robërit e Tij, se sa hidhërimi; më e dashur është falja e gabimeve se dënimi ndaj gabimtarëve. Vërtet Ai është i Butë, Fisnik, Falës dhe i Mëshirshëm.

Vërtet Allahu i Lartmadhëruar është i gatshëm për ta pranuar robin e Tij ditën dhe natën, e zgjatë dorën e Tij ditën e natën për t'ia pranuar pendimin atij i cili ka bërë gabime dhe mëkate.

Ebu Musa Eshariu r.a. transmeton se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Vërtet, Allahu e zgjatë dorën e Tij natën për t'ia pranuar pendimin mëkatarit të ditës dhe e zgjatë dorën e Tij ditën për t'ia pranuar pendimin mëkatarit të natës, deri sa të perëndojë dielli”.

(Sahih Muslim)

Eja që të pendohemi të gjithë së bashku!

Paramendoje se Allahu është paraqitur për të ta pranuar pendimin, për të të shpëtuar prej ndëshkimit dhe prej zjarrit.

Falëndero për begatinë e Allahut që të ka dhënë mundësi të pendohesh, të qëndrosh para Tij i përlur, i nënshtruar, i frikësuar.

Vëlla, pse nuk po pendohesh që sot?!

Te ju, cila është më e çmueshme: mëkati apo pendimi?

Vëlla!!

Pendohu për pasurinë të cilën e ke fituar haram!

Pendohu për pasivitetin dhe mosangazhimin tënd, në thirrje në rrugë të Allahut të Lartmadhëruar!

Pendohu për shkuarjet tua në ahengje të haramit, në shikimin e çështjeve të ndaluara në internet!

Pendohu për ngacmimet tua ndaj vajzave!

Pendohu për pasivitetin tënd dhe mosangazhimin ndaj të drejtës së vëllezërve tu në Palestinë, Irak dhe vende tjera islame!

Eja që të pendohemi të gjithë së bashku!

Analizo me vëmendje këtë shembull!

Është një sundimtar, i cili ka shumë robër. Ky sundimtar i nderonte dhe i respektonte pa masë robërit e tij. Robërit e donin për së tepërmi. Ky sundimtar i kishte ngarkuar me disa detyra dhe obligime. Në mesin e robërve ishte një rob. Një ditë një armik i sundimtarit vjen te ky rob dhe e mashtron duke i thënë: Ti nuk ke nevojë për sundimtarin, eja me mua dhe më paso se do të jesh i lirë prej atyre detyrave dhe obligimeve. Ky rob ikë nga kështjella e sundimtarit dhe shkon me armikun e sundimtarit, e ai armik ishte shejtani, mirëpo më vonë e kupton se ai armik i sundimtarit ishte shejtani dhe atë e kishte mashtruar, dhe e kishte humbur, dhe ai nuk i jepte asgjë. Ai vendosë për t'u kthyer te sundimtari. Kur i afrohet derës së kështjellës thotë: A thua a do të më pranojë sundimtari?

Mirëpo, ai befasohet me sundimtarin kur e merr për dore, prej derës së kështjellës dhe i thotë:

“Kush më afrohet mua një pëllëmbë i afrohem një hap, kush më afrohet një hap, i afrohem më shumë, kush më afrohet duke ecur unë i afrohem duke nxituar. Kush vjen te unë me mëkate të rënda sa toka, por nuk më ka mohuar, dhe nuk ka bërë idhujtari do t’ia fali mëkatet”.

(Sahih Muslim, 4953)

Vëllezër!! Padyshim, Allahu i Lartmadhëruar gëzohet me shumë se njeriu kur të kthehet te Ai, sikurse gëzohet nëna kur e gjen apo i kthehet fëmija i humbur. Pa dyshim se Allahu është më i mëshirshëm për robin e tij se nëna ndaj fëmijës së saj.

Omer ibn Hatabi transmeton se:

“Vjen pranë të Dërguarit s.a.v.s. një njeri prej fisit Sebij dhe gjinjtë e gruas së tij ishin fryrë prej qumështit të tepërt, ndërsa foshnja i kishte humbur. Kur e gjen foshnjën, gruaja e merr në gjë fëmijën dhe e ushqen me qumështin e saj. Muhamedi a.s. pyeti (sahabët): - A mundet që kjo nënë ta hedhë foshnjën e saj në zjarr? Jemi përgjigjur: - Jo, kurrsesi nuk mundet ta hedhë edhe nëse detyrohet! Atëherë Muhamedi a.s. tha: - Allahu është edhe më mëshirshëm për robërit e Tij se sa kjo nënë ndaj foshnjës së saj”.

(Sahihul Buhari, 5540)

Kushtet e pranimit të pendimit

Pendimi i sinqertë ka tri kushte:

1. Pendimi (kthimi) i sinqertë te Allahu i Lartmadhëruar.
2. Ta ndiesh veten fajtor për atë mëkat.
3. Të çrrënjosesh nga mëkati dhe
4. Vendosmëria që kurrë të mos kthehesh në mëkat.

Po nëse rob i përsëri bën mëkat dhe prapë pendohet, Allahu i Lartmadhëruar prapë ia pranon pendimin dhe ia falë gabimin.

Një beduin shkon te i Dërguari i Allahut dhe i thotë:

“O i Dërguar i Allahut, kam bërë mëkat, andaj çka ndodhë me mua?”

I Dërguari i Allahut i thotë: Të regjistrohet mëkat.

- Po nëse pendohem?
- Të fshihet mëkati.
- Po nëse e përsëriti?
- Regjistrohet.
- Po nëse pendohem?
- Të fshihet mëkati.
- Po nëse e përsëriti?
- Regjistrohet.

O i Dërguar i Allahut, po deri kur fshihen?

Muhamedi a.s. i tha: Allahu nuk e ndërpret faljen e gabimeve deri sa ju kërkon falje prej Tij”.

Vëlla!!

Ju duhet të keni vullnet të fortë, vendosmëri të sinqertë për të mos u kthyer në mëkate herën tjetër. Mirëpo, pyetja është: Prej nga buron ai vullnet i fortë dhe vendosmëri e sinqertë?

Buron nga ndjenja jote ndaj Allahut të Lartmadhëruar, fuqisë së Tij dhe madhështisë së Tij.

Buron nga frika jote prej ndëshkimit të Allahut për gabimin të cilin e bën.

Buron duke e përkujtuar vdekjen, varrin, dënimin në varr dhe përjetimet e mira në të.

Buron duke e përkujtuar Ditën e Kijametit dhe ngjarjet e asaj dite, vështirësitë e asaj dite, paraqitja e jote para Allahut dhe përgjegjësia ndaj Tij.

Buron nga dëshira për të hyrë në Xhenet dhe ikja prej zjarrit të Xhehenemit.

Buron nga përkujtimi i gjakut të vëllezërve tuaj në Afganistan, Çeçeni, Irak dhe në vende tjera të muslimanëve.

Buron nga ndjenja jote ndaj pozitës së ulët të cilën e kanë muslimanët sot, pasi që e kanë humbur Mesxhidi Aksanë, të cilën e kanë uzurpuar Jehudët stërgjyshërit e të cilëve kanë qenë derra dhe majmunë.

FORMA DHE SHEMBUJ TË PENDIMIT TE ALLAHU KRIJUES I TË GJITHË BOTËVE

Muhamed bin Abdullahu – Pejgamberi i mbrojtur prej gabimeve, të cilit i është garantuar falja e gabimeve, zotriut dhe Imamit më të mirit dhe prijësit të pendimtarëve, edhe pse Allahu i Lartmadhëruar e ka mbrojtur prej mëkateve dhe ia ka siguruar Xhenetin më të lartë Firdevsin, dhe e ka siguruar se i ka të falura gabimet, ai prapë se prapë ka kërkuar vazhdimisht falje, vazhdimisht është penduar te Zoti i Lartmadhëruar!

Vëlla!

Si është e mundur që Pejgamberi i mbrojtur prej gabimeve kërkon falje dhe pendohet, ndërsa ti nuk dëshiron të kërkossh falje dhe të pendohesh?!

Ademi a.s. dhe pendimi

Kur Ademi a.s. gaboi ndaj Zotit të Tij, iu zbuluan organet e turpshme, në atë gjendje ai ka filluar të vrapojë nëpër Xhenet. Allahu i Lartmadhëruar i ka thënë: A do të ikësh prej Meje o Adem?!

- Ademi a.s. i tha: Jo për të ikur, por për shkak të turpit tim ndaj Teje o Zot.

Allahu i Lartmadhëruar i thotë: - Zbrit prej Xhenetit. Atëherë Ademi a.s. ka filluar të qajë fort, është penduar shumë, kështu që Zoti i Lartmadhëruar ia pranoi pendimin.

Ademi a.s. edhe pas pranimit të pendimit prapë ka qarë për shkak të gabimit, atëherë Zoti i Lartmadhëruar i thotë: “O Adem, sikur të kisha caktuar që ti dhe pasardhësit e tu të mos bëjnë mëkate, atëherë cilin do ta kisha falur me mëshirën Time dhe fisnikërinë Time?!

- O Adem! Më parë ke hyrë tek Unë sikur sundimtari te Sundimtari, ndërsa sot hyn sikurse robi te Sundimtari, kjo është më e pëlqyeshme tek Unë.

- O Adem, mëkatari i nënshtruar pranë Meje është me i dashur se dëgjuesi dhe kryerësi i urdhreve, i cili kreket dhe vetëm proklamohet.

- O Adem, penduesi te Ne është më i dashur se falënderuesi i cili proklamohet”.

MUSA a.s. DHE PENDIMTARI TE ZOTI I LARTMADHËRUAR

Jetonin beni Israilët me thatësi të madhe dhe uri të madhe. Jetonin në krizë ekonomike sa që edhe shi nuk binte fare, kështu që ishin tharë pemë e perime dhe çdo gjë tjetër.

Shkojnë te Musa a.s. i tregojnë dhe kërkojnë prej tij që të bën lutje te Zoti i Lartmadhëruar për të lëshuar shi. Musa a.s. e lut Zotin për shi, mirëpo shi nuk bie. Musa a.s. tha: O Zot, të luta për shi, por shiu nuk po bie. Allahu i Lartmadhëruar i thotë:

“O Musa! Në mesin e juaj është një rob mëkatar, i cili qe katërdhjetë vite me radhë bën mëkate, prandaj për shkak të mëkateve të tij u është ndaluar shiu prej qiellit.

Musa a.s. thotë: O Zot, po ç’të bëjmë?

Allahu i Lartmadhëruar i thotë: Dëbojeni prej mesit tuaj, sepse shiu nuk do të bie deri sa ai gjendet në mesin tuaj.

Musa a.s. i thërret beni Israilët, e u thotë: Në mesin tonë është një mëkatar i cili katërdhjetë vite bën mëkate, andaj nuk do të bie shi deri sa të largohet nga ne.

Mëkatarin shikon për rreth tij, mos do ta hetojnë dhe do ta dëbojnë, sepse e dinte veten e tij, për këtë arsye ai fillon ta lusë Zotin: O Zot, nëse largohem prej beni Israilëve do të më njohin, e nëse mbes, do të vdesim urie. O Zot, ç’të bëj!

Zoti i Lartmadhëruar me mëshirën e Tij e frymëzon që të kërkojë falje, e pasi që kërkoi falje Zoti ia pranoi. Atëherë filloi të bie shiu. Musa a.s. habitet dhe thotë: O Zot, asnjë nga ne nuk u largua, ndërsa po bie shi!!

Allahu i Lartmadhëruar i thotë: O Musa, shiu po bie për shkak të pendimit të robit Tim, i cili ka bërë mëkate katërdhjetë vite.

Musa a.s. tha: O Zot, më trego atë njeri ta njoh.

Allahu i Lartmadhëruar i thotë: O Musa! Katërdhjetë vite ka bërë mëkate dhe e kam fshehur, ndërsa sot është penduar dhe kërkon që të të tregoj!

Vëlla!!

Ky është Allahu i Lartmadhëruar, fisnik, ia pranon pendimin robërve të Tij dhe nuk dëshiron për t'ia thyer zemrat e tyre.

KEAB BIN MALIKU r.a. DHE PENDIMI I TIJ TE ZOTI I LARTMADHËRUAR

Vëlla!!

Çka mendon, cila është dita më e mira e jetës sate: dita e shpëtimit, apo dita e martesës, apo dita e krijimit (lindjes)?

Nëse ke mendje të shëndoshë dhe zemër të pastër do të kishe thënë se dita më e mira e jetës tënde është dita e pendimit të Allahut i Lartmadhëruar, kur e dëgjon Atë dhe largohesh prej mëkateve.

Dita më e lumtur dhe më e mira e Keab bin Malikut ka qenë dita kur është penduar te Zoti i Lartmadhëruar!

Ka bërë gabim të madh, por pa qëllim.

Ai ka ikur prej luftës së Tebukut dhe nuk ka marrë pjesë. Muhamedi a.s. i urdhëron sehabet për ta lëçitur (për ta izoluar) për t'i bërë bllokadë. Atë e lëçitin shokët 50 ditë.

Ai pikëllohet shumë dhe e ndien veten fajtor pa masë, për atë shkak ka përjetuar vuajtje të mëdha shpirtërore, mirëpo ai e pranon fajin dhe pendohet te Zoti i Lartmadhëruar, e Ai ia pranon pendimin.

Keab bin Maliku transmeton se: Deri në luftën e Tebukut kam marrë pjesë në të gjitha luftërat, të cilat i ka zhvilluar Muhamedi a.s. , përpos në Luftën e Bedrit, Muhamedi a.s. nuk e ka qortuar asnjërin, i cili nuk ka marrë pjesë në Luftën e Bedrit. Ai ka kërkuar devenë e ngarkuar me mallra, ndërsa edhe kurejshitët kishin dalë për të kërkuar karvanin e tyre dhe janë takuar befasisht, pa e pritur njëri-tjetrin, ashtu siç e ka treguar Zoti i Madhëruar në Kur'an. Pasha jetën time, fytyra më e ndritur e Muhamedit a.s. ka qenë në Luftë e Bedrit. Atë që dua të them është se, kam qenë pjesëmarrës atë ditë kur është bërë besëlidhja në Akabe, kur e kemi pranuar islamin dhe prej atij momenti nuk jam ndarë prej Muhamedit a.s. deri në Luftën e Tebukut, e cila ka qenë lufta e fundit e tij. Atë ditë Muhamedi a.s. ka bërë thirrje për marshim ... dhe e tregon hadithin deri në fund. Pastaj thotë: Kam shkuar te Muhamedi a.s., deri sa ai ishte ulur në xhami, ndërsa shokët e tij qëndronin për rreth, fytyra i shndriste ashtu si shndritë hëna, ndërsa kur kishte lajme të mira shkëlqente. Jam ulur pran tij, e ai më tha: *“Përgëzim për ty o Keab bin Malik! Kjo është dita më e mira për ty prej asaj dite kur të ka lindur nëna.* I kam thënë: O i Dërguar i Allahut, prej Allahut

kjo apo prej juve? – *Prej Allahut*, u përgjigj Pejgamberi a.s., pastaj lexoi ajetet:

“All-llahu ia fali Pejgamberit edhe muhaxhirëve, edhe ensarëve, të cilët në çastin e vështirë shkuan pas tij, kur (nga vështirësitë) zemrat e një grupi nga ata, gati u lëkundën, por Ai ua fali (i stabilizoi zemrat e tyre) atyre. Vërtet Ai është i butë, i mëshirshëm ndaj tyre.

(Ai u fali) edhe atyre të treve, të cilëve iu pat shtyrë aq (pranimi i pendimit) sa që toka u bë e ngushtë për ta, përkundër gjerësisë së saj, kur u ngushtuan edhe shpirtrat e tyre sa që u bindën se nuk ka strehim prej All-llahut (tjetër ku) pos te Ai. Prandaj edhe atyre ua fali ai, në mënyrë që të pendohen. All-llahu pranon pendimin se është mëshirues”.

(Et-Tevbe, 117, 118)

deri tek pjesa përfundimtare e ajetit:

“... Vërtet Allahu pranon pendimin, Ai është i Mëshirshëm”. *(Et-Tevbe, 118)*

Ai tregon se për shkak të tij dhe tjerëve ka zbritur ajeti:

“Frikësohuni prej Allahut dhe radhituni me të singertit”

(Et-Tevbe, 119)

Vazhdon duke treguar:

I thashë o i Dërguar i Allahut, jam penduar dhe kam thënë se gjithmonë do ta flas të vërtetën, unë tërë

pasurinë time e jap sadaka për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Muhamedi a.s. më ka thënë: Vetëm një pjesë mbaje për vete se ke nevojë vet. Unë i thashë: Do ta marr vetëm sasinë e fituar në Hajber. Pastaj tregon Keabi se:

Pas islamit begatia më e madhe për mua ka qenë, begatia kur Muhamedi a.s. ka nxjerrë në dritë të vërtetën për mua dhe shokët e mi. Ne nuk kemi gënjyer, se për ndryshe do të ishim shkatërruar. Shpresoj se askush nuk ka rënë në provë me të Dërguarin e Allahut ashtu siç jam provuar unë. Prej atij momenti kurrë nuk kam tentuar të gënjej dhe shpresoj se Allahu do të më ruaj edhe në të ardhmen”.

(Buhariu, 4066. Muslimi, 4973. Tirmidhiu, 3027)

Vëlla!!

Bëhu si Keab bin Maliku r.a., që për ty të jetë dita më e lumtur – dita kur sot pendohesh dhe kthehesh te Zoti i Lartmadhëruar, bëhesh i dëgjueshëm ndaj Tij, i nënshtrohesh dhe largohesh prej mëkateve.

Vëllezër!!

Le të pendohet secili anëtar i umetit të Muhamedit a.s. te Allahu i Lartmadhëruar, le t’i çrrënjosin mëkatet, le t’i kthehen devotshmërisë, le ta lusin Allahun që ta ngrit islamin dhe muslimanët dhe mos t’i ulë kurrë.

Që tani të pendohemi te Allahu i Lartmadhëruar.

Aliu r.a. tregon se: Kam dëgjuar një hadith prej Muhamedit a.s., i cili hadith më ka bërë dobi sa ka dashur Allahu. Kur ndonjëri prej sehaveve më ka treguar ndonjë hadith, kam kërkuar prej tij që të përбетohet. Pasi që është përбетuar i kam besuar. Më ka treguar dhe e ka thënë të vërtetën Ebu Bekri, se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:

“Çdo musliman i cili gabon, pastaj pastrohet, falet dhe kërkon falje te Allahu, Ai ia pranon. Pastaj e ka lexuar ajetin:

135. Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetës së tyre, e përmendin All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i falë mëkatet përveç All-llahut? - dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në ata që kanë punuar (në të keqen).

136. Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre dhe xhenetet nëpër të cilët rrjedhin lumenj e aty do rrinë përgjithmonë. Sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë.

(Ali Imran, 135,136)

Sipas rivajetit të Ebu Davudit:

Muhamedi a.s. ka thënë: *“Çdo rob i cili bën ndonjë gabim, le të pastrohet mirë, pastaj le të ngritet, le t'i falë dy rekate, pastaj le të kërkojë falje prej Allahut se Allahu ia falë atij”*. Pastaj e ka lexuar këtë ajet:

135. Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetës së tyre, e përmendin All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i falë mëkatet përveç All-llahut? - dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në ata që kanë punuar (në të keqen).

136. Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre dhe xhenetet nëpër të cilët rrjedhin lumenj e aty do rrinë përgjithmonë, sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë”.

(Ali Imran, 135, 136)

Përfundim

Në fund të këtij fjalimi, shpresoj se do t'i bëjë dobi atyre të cilët e lexojnë, ashtu siç shpresojmë se do të na llogaritë Allahu këtë prej veprave të mira, le ta rangojë në peshojën e veprave të mira dhe le t'i fshijë veprat e këqija dhe lajthitjet. Shpresojmë se Allahu do të na falë gabimet dhe neglizhencën tonë. Çka ia kemi qëlluar, ajo është pjesë e diturisë që na ka dhënë Allahu dhe i dërguari i Tij; çka kemi gabuar apo harruar, është prej meje dhe prej shejtanit. Allahu dhe i Dërguari i Tij janë të pastër.

Lus Allahun të më falë, të m'i mbulojë të metat dhe gabimet e mia dhe të çdo lexuesi të këtij mesazhi.

Në fund lusim Allahun me shpresë se do të na përgjigjet dhe ta bëjë shkak që të pendohemi dhe t'i largojë nga umeti ynë brengat dhe pikëllimet.

* * *

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërimit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”.
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (*Muhamed Sajim*)
2. “Islami dhe Politika” (*nga autori Jusuf Kardavi*)
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (*Abdurrezak Nufel*)
4. “Për Kushtetutën Islame” (*Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer*)
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (*Abduhu Abas El-Velidi*)
6. “Vlera e kohës” (*nga autori Amër Halid*)
7. “Vëllazëria muslimane” (*nga autori Amër Halid*)
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (*Amër Halid*)
9. “Pendimi” (*nga autori Amër Halid*)
10. “Pasojat e mëkateve” (*nga autori Amër Halid*)

Donator
Haxhi Faik Zenuni
Fshati Duraj

Përkthyesi falënderon donatorin, njëherit e lut Allahun që ta shpërblejë në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe ta ngritë atë në shkallë të larta me pejgamberët, dëshmorët, të sinqertit dhe bamirësit.